

2018210352

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës s; Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/08, 156/10, 59/12, 187/13 dhe 41/14), Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 30.01.2018, e ka miratuar

PROGRAMIN PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E TURIZMIT PËR VITIN 2018

Neni 1

Ky program është destinuar për promovimin dhe mbështetjen e turizmit të Republikës s; Maqedoni për vitin 2018.

Mjetet e nevojshme për realizimin e Programit janë të parapara me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018 dhe arrijnë vlerën prej 162.374.000.00 denarësh, nga të cilët 119.660.000.00 denarë në llogarinë 637, 40.500.000.00 denarë në llogarinë 631 dhe 2.214.000.00 denarë në llogarinë 787 dhe të njëjtat janë planifikuar në buxhet në seksionin 10003 - Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit kategoria 42 – mallrat dhe shërbimet, 46 - subvencionet dhe transferimet dhe 48 - shpenzimet kapitale.

Neni 2

Mjetet e nenit 1, paragrafit 2 të këtij programi janë të destinuara për aktivitete promovuese dhe aktivitete për mbështetjen e turizmit si më poshtë:

a) Për aktivitete promovuese, marketing dhe bashkëpunim ndërkombëtar ndahen gjithsej 28.390.000.00 denarë, edhe atë për:

1. Pjesëmarrjen në panaiet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale turistike në Utrecht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Beograd, Berlin, Londër, Zagreb, Izmir, Varshavë, Helsinki, Tiranë, Tel Aviv, Shkup dhe qytete të tjera, si dhe pjesëmarrjen dhe organizimin e seminareve, konferencave dhe forumeve ndërkombëtare, rajonale dhe lokale investuese nga fusha e turizmit në Shkup dhe qytete të tjera dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ekonomisë turistike dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ndahen 13.000.000.00 denarë.

2. Organizimin e prezantimeve dhe takimeve me operatorët e huaj turistikë dhe ditët e turizmit të Maqedonisë jashtë vendit, organizimin e udhëtimeve informative në Republikën e Maqedonisë për operatorët e huaj turistikë dhe gazetarët (aktivitetet të cilat vazhdimisht dalin nga takimet e realizuara dhe kontaktet afariste, kërkesat e promotorëve dhe ambasadave të Republikës së Maqedonisë), si dhe për organizimin e prezantimeve dhe evenimenteve në Maqedoni ndahen 1.500.000.00 denarë.

3. Organizimin e fushatave promovuese që do të zhvillohen në Serbi, Slloveni, Kroaci, Bullgari, Shqipëri, Kosovë, Poloni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Austri, Gjermani, Francë, Turqi, Maqedoni dhe vende të tjera. Fushatat promovuese do të përfshijnë:

- Fushatat e jashtme (bilborde, reklama lëvizëse dhe jo lëvizëse),
- Reklammat në mediat e shkruara,
- Promovimin elektronik,
- Promovimin përmes blogerëve dhe
- Promovimin përmes blogerëve. Për këto aktivitete ndahen 3.000.000.00 denarë.

4. Produksionin, dizajnimin, përpilimin, shtypjen dhe distribuimin e përmbajtjeve të reja promovuese, si dhe për blerjen e materialit të vogël promovues, edhe atë:

- blerja e hartës rrugore në formë elektronike,

- produksioni i video materialeve,

- krijimi i arkivit të fotografive,

- dizajnimi i shtandeve në panaiet në të cilat merr pjesë Republika e Maqedonisë si një destinacion turistik në organizim të Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit,

- dizajnimi dhe shtypja e materialit promovues (broshura, udhëzues, fletushka, harta, biznes kartela dhe të ngjashme) dhe

- Materiali i vogël promovues (stilolapsa, gota, USB, perla e Ohrit, filigran, pako të vogla promovuese me ajvar, mjaltë dhe reçel dhe të tjera). Për këto gjëra ndahen 9.000.000,00 denarë.

5. Ridizajnimin e faqeve tashmë ekzistuese të internetit të Agjencisë për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë, hartimin e tyre, implementimin e banerave, fotografive, informacioneve, për mirëmbajtjen e tyre dhe mbështetjen teknike për funksionimin e tyre të pandërprerë ndahen 590.000.00 denarë.

6. Projektin "E75" - Përgatitja dhe shtypja e fletushkës promovuese për potencialet turistike të Republikës së Maqedonisë, të cilat gjenden përgjatë autostradës E75, si dhe shpërndarja e saj në kalimet kufitare Tabanoc dhe Bogorodicë në sezonin veror me të vetmin qëllim, konvertimi i udhëtarëve tranzitues në turistë. Për këto gjëra ndahen 1.300.000.00 denarë

b) Për aktivitetet për mbështetjen e turizmit ndahen 8.770.000.00 denarë, edhe atë për:

1. Projektin "Shtigjet malore për shëtitje" – rregullimi dhe shënimi i shtigjeve të reja malore për shëtitje, si dhe promovimi i tyre me qëllim të pasurimit të ofertës turistike të Republikës së Maqedonisë dhe zhvillimi i turizmit aktiv dhe zonave rurale;

2. Projektin "Shtigjet për vrapim malor" – rregullimi dhe shënimi i shtigjeve të reja për vrapim malor, si dhe promovimi i tyre me qëllim të pasurimit të ofertës turistike të Republikës së Maqedonisë dhe zhvillimi i turizmit aktiv dhe zonave rurale;

3. Projektin "Zhvillimi i ngjitjes sportive dhe vendosja e saj në funksion të turizmit" - zhvillimi i turizmit sportiv rekreativ, me rregullimin e lokacioneve të reja dhe sanimin e lokacioneve ekzistuese për trajnim për ngjitje nëpër shkëmb;

4. Projektin "Zhvillimi i alpinizmit dhe vendosja e tij në funksion të turizmit" - rregullimi i lokacioneve për ngjitje alpine me qëllim që të rritet siguria dhe atraktiviteti i lokacioneve dhe tërheqjen e një numri më të madh të turistëve nga njëra prej tregjeve me rritje më të shpejtë;

5. Platformën "Udhëtari i pavarur" - hartimi i potencialeve turistike në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe krijimi i një platforme të destinuar për turistët të cilët nuk përdorin shërbimet e agjencive turistike dhe organizojnë vetë udhëtimin e tyre. Me platformën do të mundësohet zhvillimi i bizneseve të vogla dhe atyre familjare në territorin e Republikës së Maqedonisë, promovimi i tyre dhe përforsimi i ekonomive lokale;

6. Rregullimin e një vendi për fluturimin e paraglajderëve në Krushevë - vendosja e barit artificial në vendin për fluturimin e paraglajderëve për të rritur sigurinë e paraglajderëve dhe për të plotësuar standardet për mbajtjen e garave ndërkombëtare me qëllim të promovimit të Republikës së Maqedonisë si një destinacion paraglajdingu;

7. Formimin e auto kampeve dhe promovimin e tyre - rritja e ofertës turistike, zhvillimi i turizmit në auto kampet, promovimi i tyre dhe tërheqja e kapitalit vendor dhe të huaj për formimin e auto kampeve;

8. Formimin, zhvillimin, rrethimin dhe shënimin e zonave zhvillimore turistike;

9. Realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizata të ndryshme ndërkombëtare të turizmit, anëtarësimi në to, si dhe përfshirja në projekte të përbashkëta për promovimin dhe zhvillimin e turizmit;

10. Përforsimin dhe zhvillimin e ofertës turistike të Republikës së Maqedonisë – organizimi i punëtorive dhe trajnimeve informative të destinuar për punëtorët e industrisë turistike, në funksion të krijimit të produkteve të reja turistike dhe promovimit të tyre, si dhe përmirësimi i

shërbimeve të servisimit me përfshirjen e ekspertëve vendorë dhe të huaj të njohur dhe operatorëve turistikë;

11. Mbështetjen financiare të manifestimeve të njohura kulturore, argëtuese, sportive, gastronomike dhe ekologjike në ngjarjet e organizuara turistike lokale, të përzgjedhura përmes shpalljes së një thirrjeje publike, e me qëllim të rritjes dhe nxitjes të ofertës turistike të Republikës së Maqedonisë;

12. Aplikimin në fondet evropiane, fondet e organizatave të donatorëve dhe të tjerë.

c) Mjetet financiare që janë të destinuara për funksionimin e Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë (qiratë, shërbimet komunale, riparimi dhe mirëmbajtja, materiali i zyrës, pajisjet dhe makinat, trajnimet, shërbimet juridike dhe të kontabilitetit etj.) dhe për këto aktivitete ndahen 6.500.000,00 denarë.

Neni 3

Për subvencionimin e qarkullimit të huaj të organizuar turistik ndahen gjithsej 76.000.000.00 denarë, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve në vlerë prej 40.500.000.00 denarësh sigurohen nga lojërat e fatit.

Neni 4

Mjetet në vlerë prej 2.214.000,00 denarësh nga llogaria 787 destinohen për organizimin e prezantimeve dhe takimeve me operatorët e huaj turistikë dhe për ditët e turizmit të Maqedonisë jashtë vendit, si dhe për organizimin i prezantimeve dhe evenimenteve në Maqedoni.

Neni 5

Për mënyrën dhe dinamikën e realizimit të këtij programi do të kujdeset Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë për aktivitetet e realizuara do të dorëzojë një raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë si dhe për rezultatet e arritura me një shpjegim për devijimet eventuale nga aktivitetet e planifikuara më së voni deri më 31 qershor 2019.

Neni 7

Ky program hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e publikimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr. 44-97/1
30 janar 2018
Shkup

Kryetari i Qeverisë së
Republikës së Maqedonisë
Zoran Zaev, (nënshkrim dore)